REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 44 datë 23.10.2025

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "OBJEKT HOTELERI DHE SHËRBIME 1, 2, 3 DHE 4 KATE MBI TOKË ME 3 KATE NËNTOKË DHE PISHINË", ME VENDNDODHJE NË GJILEKË, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues "Bega-07" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së zhvillimit për objektin: "Objekt hoteleri dhe shërbime 1, 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë me 3 kate nëntokë dhe pishinë", me vendndodhje në Gjilekë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Bega-07" sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 16, datë 13.07.2021, të KKT-së.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 16, datë 13.07.2021, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjitha procedurat administrative/ligjore për miratimin e rishikimeve dhe/ose ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit apo dhe shtyrjen e afateve, të parashikuara në nenet 17, 17/1, 18 të VKM-së 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar, për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat ligjore të Ligj Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të ti, ndërsa çertifikata e përdorimit referuar nenit 27 të VKM-së 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar, do të lëshohen nga sekretariati teknik i KKTU-së.

4. Marrëveshja përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 16, datë 13.07.2021, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 20/07/ 2026